



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 62

Prishtinë, më 3.5.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit

**Në mbledhje morën pjesë:** Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Nezir Çoçaj dhe Milena Miliçević.

**Munguan:** Doruntinë Maloku, Albulena Haxhiu, Valdete Bajrami dhe Donika Kadaj-Bujupi

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Dren Ajeti- GLSP, Shefki Kastarati- NDI, Amire Qamili-BIRN, Dibran Istrefi- “Klan Kosova”, Lumnije Berisha- ZPRK, Mërgime Kajtazi - KDI, Elton Bellopoja - NDI, Agon Foniqi - “Kosova Sot”, Lumnije Berisha- OSBE, Berat Thaçi dhe Visar Rushiti - GAP.

**Nga Staf i Komisionit:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi,** Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-081 për Energjinë;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-083 për Falimentimin;
6. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kuvendi;
7. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryesuesja propozoi që pika e dytë të hiqet nga rendi i ditës.*

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.*

### **2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-081 për Energjinë**

**Kryesuesja** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin 05/L-081 për Energjinë dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë ndonjë vërejtje.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

1. Projektligji 05/L-081 për Energjinë dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

### **3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë**

**Kryesuesja** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë ndonjë vërejtje.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

## **Rekomandim**

1. Projektligji 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

### **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-083 për Falimentimin**

**Kryesuesja** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin 05/L-083 për Falimentimin dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë ndonjë vërejtje.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

## **Rekomandim**

1. Projektligji 05/L-083 për Falimentimin dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
  2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
- ### **5. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kuvendi**

Komisioni, duke vepruar në pajtim me nenin 5 A të Ligjit nr. 05/L -033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223, mori këtë

## **V E N D I M**

- I. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- II. Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.
- III. Vendimit i bashkëngjitet teksti i konkursit, që është miratuar në Komision.

## 6. Të ndryshme

**Kryesuesja** i njoftoi anëtarët se sot, nga ora 13:00, ftoheni që të jeni të pranishëm në takimin që kemi thirrur, së bashku me z. Zemaj dhe me përfaqësuesit e KGJK-së, KPK-së, MD-së dhe ZPD-së, lidhur me rekomandimet e Komisionit për Legjislacion, të datës 7.12.2016.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Mirlinda Kolgeci

Nënkryetarja e Komisionit,  
Selvije Halimi

---